

## **BURSA SHQIPTARE E ENERGJISË ELEKTRIKE - ALPEX SHA**

### **VENDIM TEKNIK Nr. 6-C**

**Për**

**"Programin e Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes për Tregjet e ALPEX-it"**

Duke pasur parasysh dispozitat e;

1. Seksioneve D.1.1 dhe D.3.1 të Kapitullit D, seksionit E.2.3 të Kapitullit E, seksionit G.5.1 të Kapitullit G të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike - Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes për transaksionet në Tregjet e ALPEX-it, në fuqi.

#### **ALPEX SHA Miratoi:**

1. Programi i Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes për Tregjet e ALPEX-it,
2. Vendim Teknik Nr.6-C i paraqitet për njoftim Entit Rregullator të Energjisë – ERE / Zyrës së Rregullatorit për Energji - ZRRE.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**ADMINISTRATORI I ALPEX SHA**

**Sokol Dishnica**

## VENDIM TEKNIK Nr. 6-C

### NENI 1

#### 1. QËLLIMI, FUSHËVEPRIMI DHE PËRKUFIZIMET

##### 1.1. Qëllimi dhe Fushëveprimi

Ky Vendim Teknik përcakton Programin e procedurës së klerimit dhe shlyerjes në para për Tregjet e ALPEX-it.

##### 1.2. Përkufizimet

- (a) Kushtet dhe përkufizimet e përdorura në këtë Vendim Teknik do të kenë të njëjtin kuptim si në Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike - Procedurën e Tregtimit të Tregjeve të ALPEX, në Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike - Procedurën e Klerimit dhe Shlyerjes, Përkufizimeve të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike - si dhe në vendimet e tjera të miratuara në zbatim të tij.
- (b) Në çdo rast, dispozitat e këtij Vendimi Teknik interpretohen në përputhje me rregullat dhe parimet e parashikuara në paragrafin B.1.1.9 të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike - Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes.

### NENI 2

#### 2. PROGRAMI I PROCEDURES SE KLERIMIT DHE SHLYERJES

Programi për zbatimin e procedurës së klerimit dhe shlyerjes përshkruhet në tabelën e mëposhtme:

Procedura e Klerimit	Koha e fillimit të procesit të Klerimit (T) për çdo ditë pune të Kalendarit të Ditëve të Klerimit
Hapja e Llogarisë së Klerimit dhe Krijimi i Strukturës nga ALPEX në EMCS	<b>nga ora 9:00 deri në orën 15:00</b>
Njoftimi i ETSS me Strukturën e Llogarive të Klerimit	<b>nga ora 15:30 deri në orën 16:00</b>
Dorëzimi i Letër Garancisë Bankare me qëllim që të mbulohen kërkesat e margjinës dhe rritja kufiri të kreditit	<b>nga ora 10:00 deri në orën 16:00</b>
Aplikim për Kthimin përpara kohe të Letër Garancisë Bankare	<b>nga ora 9:00 deri në orën 15:00</b>
Kthimi i Letër Garancisë Bankare nga ALPEX	<b>nga ora 10:00 deri në orën 16:00</b>
Aplikimi për depozitimin e parave, për rritjen e kufirit të kreditit (sipas disponueshmërisë së Bankës për Shlyerje)	<b>nga ora 9:00 deri në orën 15:30</b>
Aplikimi për Kthimin e Garancisë në para	<b>nga ora 9:00 deri në orën 14:00</b>

Ndryshimi i Kufirit të Kreditit nga Anëtarët e Klerimit	<b>në mënyrë të vazhdueshme</b>
Pagesa nga Anëtari i Klerimit/Anëtari i Bursës të shumave të kërkuara për shlyerjen në para si dhe për çdo taksë, tarifë variable dhe fikse dhe tarifa të tjera në favor të ALPEX-it	<b>deri në orën 11:00</b>
Pagesa nga Anëtari i Klerimit për shumën e kërkuar, për shkak të rirregullimit të pjesës së tij proporcionale në Fondin e Mospërmbushjes së Detyrimeve	<b>deri në orën 11:00</b>
Finalizimi i transaksioneve për klerimin të cilat janë njoftuar nga ETSS në EMCS prej orës 15:00 të ditës së mëparshme të klerimit, deri në orën 15:00 të ditës së klerimit	<b>në orën 15:15</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Llogaritja e Debitorëve të ALPEX-it dhe Kreditorëve të ALPEX-it</li> <li>• Vlerësimi i Garancisë</li> <li>• Llogaritja dhe mbulimi i Kërkesave të Margjinës</li> <li>• Llogaritja e Kufirit të ri të Kreditit dhe njoftimi në ETSS</li> </ul>	<b>Nga ora 15:15 deri në orën 15:30</b>
Eksportimi i skedarëve dhe raportimi duke përfshirë rezultatet e procedurës së klerimit	<b>nga ora 15:30</b>

Programi i Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes mund të ndryshohet nga ALPEX-i, siç mund të jetë rasti, në rastet e vonesave ose mosfunksionimit të EMCS-së ose ndonjë ngjarjeje tjetër të jashtëzakonshme ose ngjarje e forcës madhore. ALPEX-i njofton Anëtarët e Klerimit me çdo mjet të përshtatshëm.

### **NENI 3**

#### **3. HYRJA NË FUQI**

Ky Vendim Teknik hyn në fuqi që nga data 07/09/2023.

Ky Vendim Teknik do të publikohet në faqen zyrtare të internetit [www.alpex.al](http://www.alpex.al).